



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR
SEKTORI JURIDIK

Nr. 5097/prot.

Tiranë, më 28.09.2020

Lënda: Dhënie mendimi për projektligjin “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

MINISTRISË SË MBROJTJES
Rruga e Dibrës, Tiranë

Në përgjigje Tuajës nr. 3700/1 Prot., datë 01.09.2020, ku kërkohet dhënie mendimi për projektligjin, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”, Ju informon se:

Ligji nr.10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është i zbatueshëm për të gjitha institucionet që kryejnë funksione inspektimi. Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj janë hartuar dhe miratuar rregulla për programimin e inspektimeve, metodologjinë e vlerësimit të riskut, si dhe ka standardizuar të gjithë dokumentacionin e veprimtarisë së inspektimit për të gjitha fushat e inspektimit, duke sjellë edhe kryerjen e veprimtaria inspektuese online nëpërmjet portalit “e-Inspektimi”.

Lidhur me këtë projektligj Inspektorati Qendror shpreh dakordësinë në tërësi, por sygjeron sa vijon:

- ✓ Në nenin 3, “**Përkufizime**”, të këtij ligji të shtohet edhe kuptimi i termave “*inspektim*”, dhe “*subjekt i inspektimit*”, sipas ligjit për inspektimin dhe konkretisht:

“Inspektim” është çdo formë kontrolli që organi publik kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

“Subjekti i inspektimit” është çdo person fizik apo juridik, privat apo publik, që ka, sipas ligjit, detyrimin të respektojë një kërkesë ligjore.

- ✓ Në nenin 33, në paragrafin e fundit të pikës 1, të shtohet edhe togfjalëshi:

Këto struktura kryejnë inspektimet për të verifikuar përputhshmërinë e lëndëve plasëse dhe përmbushjen e kriterëve dhe kërkesave të këtij ligji, **sipas ligjit për inspektimin.**


- ✓ Pika 2 e nenit, 38 të bëhet: “*Nëpunësit e përmendur në pikën 1 të këtij neni, të kryejnë inspektimin në përputhje me ligjin për inspektimin.*”.

- ✓ Nga pika 3-7 e nenit 38, procedimi administrativ duhet të kryhet sipas ligjit për inspektimin, si dhe të saktësohet procedura e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

SHKËLQIM HAJDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR
SEKTORI JURIDIK

Nr. 504 prot.

Tiranë, më 28. 09. 2020

Lënda: Dhënie mendimi për projektligjin “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”.

MINISTRISË SË MBROJTJES
Rruga e Dibrës, Tiranë

Në përgjigje Tuajës nr. 3708/1 Prot., datë 01.09.2020, ku kërkohet dhënie mendimi për projektligjin, “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e artikujve piroteknikë”, Inspektorati Qendror, Ju informon se:

Ligji nr.10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, është i zbatueshëm për të gjitha institucionet që kryejnë funksione inspektimi. Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj janë hartuar dhe miratuar rregulla për programimin e inspektimeve, metodologjinë e vlerësimit të riskut, si dhe ka standardizuar të gjithë dokumentacionin e veprimtarisë së inspektimit për të gjitha fushat e inspektimit, duke sjellë edhe kryerjen e veprimtaria inspektuese online nëpërmjet portalit “e-Inspektimi”.

Lidhur me këtë projektligj Inspektorati Qendror shpreh dakordësinë në tërësi, por sygjeron sa vijon:

- ✓ Në nenin 2, “**Përkufizime**”, të këtij ligji të shtohet edhe kuptimi i termave “*inspektim*”, dhe “*subjekt i inspektimit*”, sipas ligjit për inspektimin dhe konkretisht:

“Inspektim” është çdo formë kontrolli që organi publik kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.

“Subjekti i inspektimit” është çdo person fizik apo juridik, privat apo publik, që ka, sipas ligjit, detyrimin të respektojë një kërkesë ligjore.

- ✓ Në nenin 36, në paragrafin e fundit të pikës 1, të shtohet edhe togfjalëshi:
Këto struktura ... përmbushjen e kriterëve dhe kërkesave të këtij ligji, sipas ligjit për inspektimin.
- ✓ Në nenin 41, “**Inspektimi**”, strukturat e mbikëqyrjes së tregut janë të përcaktuara në nenin 36, të ligjit. (të korrigohet pasi i referohet nenit 37).
- ✓ Pika 2 e nenit, 41 të bëhet: “*Nëpunësit e përmendur në pikën 1 të këtij neni, të kryejnë inspektimin në përputhje me ligjin për inspektimin*”.

- ✓ Nga pika 3-7 e nenit 41, procedimi administrativ duhet të kryhet sipas ligjit për inspektimin, si dhe të saktësohet procedura e ankimimit ndaj vendimit përfundimtar.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

SHKËLQIM HAJDARI

